



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
 REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
 МИНИСТЕРСТВО ЗА СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА,
 ДЕМОГРАФИЈА И МЛАДИ - СКОПЈЕ
 MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE E
 DEMOGRAFISË DHE E TË RINJVE - SHKUP

Бр. / Nr. 22-4225/1

03-06-2026 20 год. / viti

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
 MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE TË RINJVE

THIRRJE PUBLIKE PËR SIGURIM TË MJETEVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE
 SOCIALE NGA KOMUNAT, QYTETI I SHKUPIT DHE KOMUNAT NË QYTETIN E
 SHKUPIT

Në bazë të nenit 140 paragrafi 1 të Ligjit për Mbrojtjen Sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21, 294/21, 99/21, 236/22, 65/23 dhe 192/25), Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve publikon Thirrje Publike për sigurimin e mjeteve për ofrimin e shërbimeve sociale NGA KOMUNAT, QYTETI I SHKUPIT DHE KOMUNAT NË QYTETIN E SHKUPIT, që do të realizohet në bashkëpunim me ofrues të licencuar shërbimesh, me mbështetje financiare nga Ministria, dhe për grupet e qytetarëve të cenuar, për të cilët është përcaktuar nevoja për një lloj të caktuar shërbimi, me qëllim vazhdimin e ofrimit të shërbimeve sociale të vendosura në nivel lokal dhe që realizohen nga një ofrues i licencuar shërbimesh përmes Projektit të Përmirësimit të Shërbimeve Sociale.

1. Lloji i shërbimeve:

Me këtë thirrje u sigurohen mjete komunave për ofrimin e:

1. Shërbimeve komunitare:

- Qendrave të kujdesit ditor për persona me aftësi të kufizuara dhe punë individuale

2. Shuma e mjeteve të cilat jepen dhe periodha kohore në të cilën do të ofrohen shërbimet sociale

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve do të sigurojë mjete për ofrimin e shërbimeve sociale nga komunat në bashkëpunim me ofrues të licencuar të shërbimeve sociale, me çmimin e shërbimit të përcaktuar me Vendimin për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve sociale në shtëpi, për kujdesin jashtë familjar, për ndihmën dhe mbështetjen profesionale, për qëndrim ditor, për qëndrim të përkohshëm, për këshillimin dhe pushimin nga kujdesi familjar për vitin 2026, të miratuar nga Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve nr. 02-8269/1 të datës 22.12.2025, përgatitur në përputhje me Metodologjinë për



formimin e çmimeve të shërbimeve në varësi të normave dhe standardeve për ofrimin e shërbimeve sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 264/19). Mjetet do të sigurohen për përfitues në bazë mujore, për të cilat Qendra për Punë Sociale ka nxjerrë aktvendim, në periudhën nga data e përfundimit të mbështetjes financiare përmes marrëveshjes së grantit deri më 31.12.2026.

3. Dokumentet e nevojshme:

Nëse shërbimi ofrohet nga qendra për shërbime sociale të themeluar nga komuna, bashkëngjiten dokumentet në vijim:

1. Fletëparaqitje (Formulari për aplikim për ofrimin e shërbimeve, publikuar në veb faqen e Ministrisë www.mtsp.gov.mk) nënshkruar dhe vërtetuar nga Kryetari i Komunës,
2. Programi për ofrimin e shërbimit social dhe përshkrim të detajuar të aktiviteteve me një plan pune konkret për zbatimin dhe periudhën e realizimit të programit për ofrimin e shërbimit social për të cilin kërkohet ndarja e mjeteve, emri i plotë dhe adresa e subjektit që do të zbatojë programin për ofrimin e shërbimit social,
3. Dokument për partneritetin e krijuar, bashkëpunimin ndërsektorial dhe bashkëfinancimin e siguruar (nëse ka),
4. Të dhënat kontaktuese për personin përgjegjës/koordinatorin për realizimin e programit të ofrimit të shërbimeve sociale (emri, mbiemri, email-adresa dhe numri i telefonit) dhe një listë të dhënash për stafin profesional dhe personat e angazhuar në ofrimin e shërbimeve sociale,
5. Deklaratë nga komuna se nuk ka marrë mjete të tjera për ofrimin e shërbimit,
6. Raporti vjetor mbi punën e vitit të kaluar dhe llogaritë përfundimtare për vitin e kaluar të qendrës së shërbimeve sociale,,
7. Plani vjetor për burimet financiare dhe materiale për ofrimin e shërbimit të qendrës së shërbimeve sociale.

Komunat, për qendër shërbimesh sociale të themeluar në vitin aktual në të cilin publikohet thirrja publike, nuk i dorëzon dokumentet nga pikat 6 dhe 7.

Nëse shërbimi social realizohet nëpërmjet bashkëpunimit midis komunave me ofrues të licencuar të shërbimeve sociale, bashkëngjiten dokumentet në vijim:

1. Fletëparaqitje (Formulari i aplikimit për ofrimin e shërbimeve, publikuar në veb faqen e Ministrisë www.mtsp.gov.mk) nënshkruar dhe vërtetuar nga Kryetari i Komunës,
2. Marrëveshje bashkëpunimi me ofrues të licencuar të shërbimeve sociale,
3. Programi për ofrimin e shërbimit social dhe përshkrim i detajuar i aktiviteteve me një plan pune specifik për zbatimin dhe periudhën e realizimit të programit për ofrimin e



- shërbimit social për të cilin kërkohet ndarja e mjeteve, emri i plotë dhe adresa e subjektit që do të zbatojë programin për ofrimin e shërbimit social,
4. Raporti vjetor mbi punën për vitin e kaluar, përkatësisht për vitin 2025, të ofruesit të licencuar të shërbimeve sociale
 5. Vërtetim të taksave të paguara të lëshuar nga organe tatimore të ofruesit të licencuar të shërbimeve sociale, jo më e vjetër se gjashtë muaj (origjinale ose kopje e noterizuar),
 6. Të dhënat kontaktuese për personin përgjegjës/koordinatorin për realizimin e programit për ofrimin e shërbimeve sociale (emri, mbiemri, email-adresa dhe numri i telefonit),
 7. Lista e të dhënave mbi stafin profesional dhe personat e angazhuar në ofrimin e shërbimeve sociale,
 8. Deklaratë nga ofruesi i licencuar i shërbimeve sociale, vërtetuar nga noteri, se nuk ka marrë mjete nga një organ tjetër shtetëror ose njësi e qeverisjes lokale për të njëjtat aktivitete për ofrimin e shërbimit,
 9. Aktvendimi për dhënien e lejes për kryerjen e punës në mbrojtjen sociale dhe të gjitha ndryshimet shtesë (origjinali ose një kopje e noterizuar),
 10. Dëshmi e një mekanizmi të vendosur për kontrollin e cilësisë së shërbimit dhe sistem ankesash të klientëve (formularë).
 11. Marrëveshje Granti e nënshkruar për Zhvillimin e Shërbimeve Sociale në kuadër të “Projektit të Përmirësimit të Shërbimeve Sociale” (Numri i Marrëveshjes së Kredisë #8902-MK/ #9633-MK)

Ofruesi i licencuar i shërbimeve që ka marrë leje pune në vitin aktual në të cilin publikohet thirrja publike nuk i paraqet dokumentet nga pikat 4 dhe 5.

4. Afatet për zbatimin e procedurës:

Thirrja publike zgjat 5 ditë nga data e publikimit në veb faqen e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve.

Komunat e interesuara duhet t’i dorëzojnë fletëparaqitjet e tyre përmes arkivit të Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve në adresën: rr. Dame Gruev nr. 14, Shkup, në një zarf të mbyllur, me shënim për Thirrjen Publike për sigurimin e mjeteve për ofrimin shërbimeve sociale nga Komunat, Qyteti i Shkupit dhe Komunat në Qytetin e Shkupit për vitin 2026.

Fletëparaqitjet të cilat do të dorëzohen pas këtij afati dhe me dokumentacion të paplotë nuk do të merren në konsideratë.



Komisioni për Sigurimin e Mjeteve, brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit së fletëparaqitjes, përgatit një mendim për Ministrin e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, pas një procedure të zbatuar, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen Sociale dhe Rregulloren për kushtet e hollësishme për dhënien e mjeteve, formën e shkallës së pikëzimit dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve sociale nga Komunat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 163/22, nr. 269/2022).

Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, pasi merr mendim nga Komisioni për Sigurimin e Mjeteve për Shërbime Sociale nga Komunat dhe Ofruesit e Tjerë, miraton një aktvendim për ndarjen e mjeteve.

Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve do të lidhë Marrëveshje Administrative me komunat dhe ofruesin e licencuar të shërbimeve, që rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e ndërsjella në realizimin e mjeteve të dhëna, brenda 15 ditëve nga data përfundimit të vendimit për ndarjen e mjeteve.

Komunat që do të marrin mjete nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve janë të detyruar të sigurojnë të gjitha materialet (të shtypura dhe elektronike) që do të prodhohen në kuadër të ofrimit të shërbimit në një vend të dukshëm të qëndrojnë:

Mbështetur nga:



Република Северна Македонија

MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE TË RINJVE